


# ALARM 37

## KUSH DO TË PAGUAN BORXHIN PREJ 1.5 MILION EURO?

Shpenzimet e plota që kanë raportuar partitë për 10 ditët e dyta të fushatës zgjedhore janë 1 milion dhe 900 mijë euro, për dallim nga 1 milion dhe 300 mijë euro gjatë 10 ditëve të para<sup>1</sup>.

**3.200.000€** Gjithsej shpenzime në fushatën zgjedhore



### PARTIA DOMINUESE NË PUSHTET

Prej gjithsej 3 milion e 200 mijë euro të harxhuara nga partitë gjatë 20 ditëve të fushatës, vetëm koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE ka shpenzuar mbi 1 milion e 900 mijë euro, ndërsa gjitha 10 partitë/koalicionet tjera bashkë kanë shpenzuar 1 milion e 300 mijë euro.



**3.200.000€**

gjithsej shpenzime në fushatën zgjedhore

### 3.5 HERË DALLIM MË TË LARTË


Të dhënat tregojnë një trend të rritjes së shpenzimeve në fushatën zgjedhore tek koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE. VMRO-DPMNE ka shpenzuar mbi 1 milion e 900 mijë euro që është 3.5 herë më e lartë nga shpenzimet e LSDM në fushatë prej 550 mijë euro.

**VMRO-DPMNE**  
**1.900.000€**

**LSDM**  
**550.000€**


### SHPENZIM I PA KONSIDERUESHËM!

Përskaj borxhit prej 600 mijë euro me të cilat ka përfunduar 10 ditë e para të fushatës zgjedhore, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE ka vazhduar me shpenzimet e pakonsiderueshme dhe rritje të borxheve. Gjatë 20 ditëve të fushatës zgjedhore, VMRO-DPMNE ka mbledhur donacione prej 300 mijë euro, ndërsa ka shpenzuar gjithsej 1 milion e 900 mijë euro. Kanë shpenzuar 5 herë më tepër nga që kanë fituar donacione! Në fund të fushatës borxhi i tyre është 1 milion e 600 mijë euro.



### KUSH DO TË PAGUAJË BORXHIN PREJ 1 MILION E 500 MIJË EURO?

Nëse pritet që koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE do të fitojë kthim nga shteti për votat e fituara prej 110 mijë euro, mbetet e paqartë kush do të paguajë borxhin prej 1 milion e 500 mijë euro?



<sup>1</sup>Burimi: Raporti i parë dhe i dytë i partive (organizatorëve të fushatave) për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2016. <http://www.sec.mk/finansiski-izveshtaj-za-prihodi-i-rashodi-na-politichkite-partii/>  
<sup>2</sup> Sipas rezultateve fillestare të publikuar nga KSHZ-ja <https://rezultati.sec.mk/Parliamentary/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1> koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE ka fituar 454.253 vota, dhe për të cilat për një votë të fituar nga shteti vijon kompensim prej 15 dinarëve (në përputhje me Nenin 86 të Kodit Zgjedhore).